



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 05.07.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:09 dhe mbaroi në orën 12:42.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
7. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
8. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Edlira Bako, Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
10. *Marjana Papa, OSCE.*
11. *Klodian Rado, EURALIUS.*
12. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
13. *Ervin Karamuço, ISP.*
14. *Klara Kodra, Qendra Evropiane.*
15. *Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, i përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Naureda Llagami: Përsëritje të nderuar anëtarë!

Sot do zhvillojmë mbledhjen e parashikuar për datën 5 korrik 2019.

Të pranishëm janë të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sikurse jeni në dijeni, në mbledhjen e sotshme janë për diskutim 5 çështje në rendin e ditës, konkretisht

është: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërimin në Gjykatën e Lartë”; Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicionit Këshilltar Ligjor në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurat e komandimit në këtë pozicion”; Së treti: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë”; Shqyrtimin e projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarës {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit” dhe çështja e pestë, janë Të tjera. Jeni dakord me rendin e ditës?

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Unë do doja në fakt, për shkak të rëndësisë së një nga projekt rregulloret që sot Këshilli do marri në shqyrtim, doja të theksoja se kjo projekt rregullore që lidhet me kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjen e kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërimin në Gjykatën e Lartë, është një ndër rregulloret më të rëndësishme që Këshilli po miraton përgjatë këtyre muajve të parë të funksionimit të tij, përkrah 101 vendimmarrjeve të marra nga Këshilli në lidhje me çështjet thelbësore që kërkojnë përgjigje emergjente, për të lejuar funksionimin normal të sistemit gjyqësor në tërësi, duke filluar nga domosdoshmëria e mirëfunksionimit të gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatës së apelit, që ndikojnë drejtpërdrejtë në aksesin e qytetarëve në drejtësi.

Këto nisma kanë mundësuar ndërmarrjen e disa iniciativave nga KLGJ, ndaj më lejoni t’iu kujtoj sa më poshtë:

Ngritjen e veprimtarisë organizative të vetë KLGJ-së për të siguruar operacionalizimin e saj dhe përgjigjen ndaj nevojave të sistemit;

Mbështetjen e procesit të “vettingut” duke kryer me përparësi vlerësimet profesionale të gjyqtarëve për të ruajtur ritmin e duhur dhe për të mos ngadalësuar procesin si prioritet që është përcaktuar në ligj;

Hartimin e rregullave për skemën e delegimit dhe transferimit të përkohshëm, si dhe caktimin e gjyqtarëve për të mundësuar plotësimin e vakancave të krijuara nga

largimet nga sistemi në rastet kur rrezikohej edhe drejtimi i gjykatave, por në të njëjtën kohë edhe për të mundësuar plotësimet me gjyqtarë kur gjykatat janë gjendur në pamundësi për të formuar trupat gjyqësore. Duhet të përmend këtu 485 kërkesa të adresuara KLGJ-së nga gjykatat e vendit për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e 706 çështjeve të gjykatave të ndryshme nga ato ku ushtrojnë detyrën;

Sigurisht, pa lënë mënjanë dhe veprimet e nevojshme, për emërimin e magistratëve, hartimin e akteve për ngritjen e Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si dhe nisjen e procesit që mundëson propozimin dhe emërimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

Sa i përket Gjykatës së Lartë, duke e njohur si prioritet kombëtar, Këshilli prej disa muajsh ka punuar intensivisht për hartimin e akteve të nevojshme, duke u siguruar të marrë hapa të kujdesshëm dhe duke u konsultuar në çdo hap me partnerët ndërkombëtarë, në mënyrë që çdo vendimmarrje që do të pasojë t'i shërbejë zgjidhjes së situatës në këtë gjykatë, frymës së reformës dhe instalimit përfundimtar të sundimit të ligjit.

Projekt-akti që do të diskutohet sot ka kërkuar një kohë të nevojshme për të trajtuar me seriozitet dhe përgjegjësi çdo element të tij, për të mundësuar kriteret e qarta dhe transparente, vlerësim objektiv të çdo kandidature, si dhe një metodologji që kërkon një procedurë pikëzimi të saktë duke garantuar të drejtat e kandidatëve në këtë proces.

Ky projektvendim, pason aktin që KLGJ miratoi thuajse dy muaj më parë, duke përcaktuar procedurën që do të ndiqet për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë.

Ndaj sot, me shqyrtimin dhe miratimin e vendimit për caktimin të kriterëve të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes së tyre, në përmbushje të të gjithë synimeve dhe përgjegjësisë të përcaktuara nga Kushtetuta në nenin 147, pika 1 dhe kuadrit ligjor të miratuar në funksion të Reformës në Drejtësi, Këshilli i Lartë Gjyqësor i hap rrugë nisjes së procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve jo-gjyqtarë për emërim në Gjykatën e Lartë, duke ndikuar kështu, drejtpërdrejt në krijimin e mundësive për bërjen funksionale të kësaj gjykate.

Për ta na dhënë më shumë informacion lidhur me përmbajtjen e këtij projekt-akti unë dëshiroj t'ia jap fjalën kryetarit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, zotit. Ilir Toska. Faleminderit!

Atëherë, duke qenë se në rendin e ditës janë disa çështje, unë propozoj që kamerat të largohen dhe të vazhdojnë të rrinë gazetarët, për transparencë të mbledhjes së Këshillit.

Mbledhje e Këshillit janë gjithmonë të hapura. Kush ka paraqitur kërkesë për të qenë prezent (si nga shoqëria civile, si nga individë, si nga gazetarë), kanë ardhur dhe i kanë ndjekur mbledhjet e Këshillit.

Lidhur me prezencën e kamerës, ky është një vendim që Këshilli ka mbajtur një standard dhe do vlerësohet rast pas rasti, kur çështjet përbëjnë një interes publik dhe kur neve e gjykojmë që duhet të jetë edhe transparenca.

(Përfaqësuesit e medias largohen nga salla e mbledhjes për t'u rifitur më pas vetëm gazetarët. Gjatë kësaj kohe anëtarët e Këshillit diskutojnë për mundësinë e pranisë apo jo të kamerave dhe gazetarëve në mbledhjet plenare të Këshillit dhe pas këtyre diskutimeve vendosin që të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes plenare, të jenë vetëm gazetarët.)

Në vijim, ia kaloj fjalën kryetarit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, zotit Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni, krahas projektvendimit “Për kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, ka përgatitur edhe një relacion të shkurtër në lidhje me përmbajtjen e këtij projektvendimi.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësive për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të efijencës, në ushtrim të kompetencave në lidhje me administrimin e sistemit gjyqësor, bazuar në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 3, 4 dhe 49 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka filluar procesin për miratimin e rregullave më të detajuara, të cilat do të përcaktojnë kriteret dhe procedurën që do të zbatohet për përzgjedhjen e kandidatëve jo-gjyqtarë që do t'i

propozohen Presidentit të Republikës për emërimin në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka hartuar projektvendimin “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, i cili i hap rrugë emërimit të kandidatëve jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, konform parashikimit ligjor që përcakton se një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës, të cilët nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Miratimi i këtij vendimi, është mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 3, 4 dhe 49 të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku në pikën 12 të këtij të fundit përcaktohet shprehimisht se Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë:

- a) kriteret për vlerësimin e përvojës në fusha të veçanta;
- b) kriteret dhe procedurën për vlerësimin e aftësive profesionale;
- c) procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta.

Ky projektvendim është në vijim të vendimit nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i cili në Kreun X, Seksioni Ç ka përcaktuar se procedura e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidateve rregullohet me akt të veçantë të Këshillit. Me miratimin e këtij projektvendimi përmbyllet kuadri rregullator, që do të mundësojë më pas hapjen e procedurave për emërimin e jo-gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë.

Duhet nënvizuar fakti se hartimi i këtij projektvendimi ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë dhe të vazhdueshëm me ekspertët e misionëve partnere, kryesisht EURALIUS, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar në këtë drejtim.

Lidhur me përmbajtjen e këtij projektvendimi, ai përbëhet nga 7 (shtatë) krerë, si më poshtë:

Në Kreu I, titulluar “Qëllimi dhe objekti”, përcaktohet qëllimi dhe objekti i projektvendimit, ku në mënyrë të përmbledhur theksohet se ky projektvendim synon të përcaktojë kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë, si dhe të rregullave më të hollësishme mbi procedurën e përzgjedhjes për emërim të kandidatëve jo-gjyqtarë në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë. Për sa i përket objektit, në pikën 2 të Kreut I përcaktohet se projektvendimi parashikon rregulla më të detajuar në lidhje me kriteret për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve jo-gjyqtarë për një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, si dhe veprimet dhe procedurat që Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të kryejë për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve jo-gjyqtarë, në funksion të përzgjedhjes dhe propozimit për t’u emëruar, në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, të juristit më të spikatur.

Në Kreun II, titulluar “Kudri ligjor”, projektvendimi ka listuar aktet ligjore sipas të cilit do të interpretohet dhe zbatohet projektvendimi.

Ndërsa në Kreun III, titulluar “Përkufizimet”, jepen përkufizimet që do të kenë termat e përdorura në vendim.

Në Kreun IV, titulluar “Kriteret për vlerësimin e kandidatëve, pesha e tyre specifike dhe pikëzimi”, i cili përbëhet nga 7 pika, përcaktohen kriteret që do të ndiqen për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve me qëllim identifikimin e kandidatit jo-gjyqtar që përfaqëson juristin më të spikatur, i cili do të propozohet për t’u emëruar në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë Presidentit të Republikës. Kategoritë e kriterëve që do të vlerësohen me qëllim identifikimin e juristit më të spikatur, janë meritat profesionale; meritat morale dhe etike dhe meritat organizative dhe menaxheriale.

Vlen të përmendet se vlerat themelore dhe të drejtat dhe detyrimet e përgjithshme të magjistratit (neni 3 i ligjit të statusit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë), standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes (sipas nenit 4 të këtij ligji), janë orientim për cilindo që kërkon të ketë titullin magjistrat. Për më tepër, që vlera të tilla patjetër që duhet të jenë një prioritet për ata që duan të jenë gjyqtarë të Gjykatës së Lartë.

Po ashtu, sa i përket kritereve të vlerësimit të kandidatit për në Gjykatën e Lartë, Komisioni ka patur parasysh edhe përmbushjen e atyre treguesve ligjorë që nevojiten për të ngritur në detyrë një magjistrat, apo për të realizuar procesin e “vlerësimit të magjistratit”. Konkretisht, në kriteret që shërbejnë për vlerësimin e magjistratit përfshihen aftësitë profesionale, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale si dhe aftësitë personale dhe angazhimi profesional (neni 71 i ligjit të Statusit). Pikërisht për kriteret ligjore nevojitet domosdoshmërisht një vlerësim diskrecionar nga KLGJ, që ndihmohet nga një sistem i qartë pikëzimi. Për këto arsye, verifikimi i kritereve të vlerësimit për kandidatin për Gjykatën e Lartë dhe më pas, renditja e tyre, është konsideruar se duhet të bëhet domosdoshmërisht mbi tre kolona bazë, ashtu sikurse ligji ka pranuar për ngritjen në detyrë të magjistratëve, si dhe për emërimin e kandidatëve në Gjykatën Kushtetuese, ku mes këtyre të fundit dhe kandidatëve për në Gjykatën e Lartë nuk duhet të ketë dallim për shkak të pozicionit që mbajnë gjyqtarët e dy gjykatave, si gjykatat orientuese për praktikën gjyqësore. Prandaj, verifikimi i kritereve ligjore dhe renditja sipas aftësive të kandidatëve të Gjykatës së Lartë, është propozuar të bëhet mbi: a) meritat profesionale; b) meritat morale dhe c) meritat organizative dhe menaxheriale.

Për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve, është parashikuar që Këshilli të mbështetet në disa tregues, siç janë: ekspertiza e veçantë e kandidatit në fusha të veçanta të ligjit, sipas kërkesave të shpallura për pozicionin e lirë, duke patur parasysh për këtë nenin 31 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; vlerësimi i punës së kandidatit, përmes të paktën 5 (pesë) dokumenteve ligjore, të hartuara nga kandidati gjatë përvojës së tij në profesion në 5 (pesë) vitet e fundit, si dhe çdo publikim shkencor dhe artikull akademik në fushën e ligjit sipas rëndësisë së punimit, nëpërmjet të cilave tregohen të dhëna edhe për pjesëmarrjen e kandidatit në aktivitetet shkencore, në procese të hartimit ose të konsultimit të legjislativitetit apo në çdo angazhim tjetër profesional; rezultatet e studimeve të larta për drejtësi, të Programit të Formimit Fillestar, përvojës në profesion ose çdo trajnimi tjetër; cilësitë morale të kandidatit, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për

të marrë përsipër përgjegjësi; cilësia e platformës dhe e vizionit të kandidatit, për aftësitë e tij për të marrë vendime dhe përgjegjësi referuar përvojave të mëparshme profesionale, për aftësitë e komunikimit, për aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore; si dhe aftësitë gjuhësore të kandidatit, të treguara nëpërmjet certifikatave dhe gjatë intervistimit. Ndërkohë detajimi i mëtejshëm i kategorive të kriterëve të vlerësimit dhe i treguesve për secilën nga ato, përcaktimi i peshës specifike të tyre në pikëzimin e kandidatëve, përcaktohet në Shtojcën e këtij vendimi.

Këshilli, gjithashtu, në ditët në vijim, do të miratojë metodologjinë mbi të cilën bazohet për vlerësimin dhe caktimin e pikëve lidhur me secilin prej kriterëve dhe treguesve të treguar në Shtojcën e këtij vendimi, duke u bazuar për këtë në të dhënat metodologjike që janë pjesë e Shtojcës së vendimit që do duhet të miratojmë.

Në Kreun V, titulluar “Rregulla të përgjithshme të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve”, projektvendimi ka përcaktuar fazën fillestare të procedurës së përzgjedhjes të kandidatëve jo-gjyqtarë që do të propozohen për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë. Konkretisht, Seksioni A, i Kreut V rregullon në mënyrë të hollësishme fillimin dhe fazat e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve. Seksioni B i këtij Kreu ka përcaktuar të drejtat e kandidatit në këtë fazë, siç është e drejta e njoftimit për relatorin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve dhe për të kërkuar përjashtimin e relatorit të çështjes për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75 të Ligjit për Qeverisjen, e drejta për të paraqitur pranë Këshillit dokumentet që i çmon të nevojshme për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturës, të drejtën që, në çdo fazë të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim, me kërkesën e tij, të njihet me dokumentet e dosjes së kandidimit dhe aktet procedurale të kryera nga relatori dhe Këshilli, të paraqesë shpjegime me shkrim për çështje që lidhen me kriteret e vlerësimit, e drejta e kandidatit i listuar më mirë, për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore, si dhe e drejta për t’u tërhequr nga kandidimi derisa Këshilli nuk ka përfunduar ende procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve që do të propozohen për t’u emëruar. Seksioni C ka rregulluar afatet dhe mënyrën e llogaritjes së tyre në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve. Ndërsa, Seksioni Ç ka parashikuar

rregulla të detajuara për sa i përket njoftimeve që Këshilli ia drejton kandidatit, si dhe për njoftimet dhe kërkesat e kandidatit drejtuar Këshillit.

Në Kreu VI, titulluar “Fazat e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve”, përcaktohen dhe rregullohen në mënyrë të hollësishme të gjitha fazat që do të ndjekë Këshilli gjatë procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve. Konkretisht, Seksioni A ka parashikuar të gjitha veprimet përgatitore që do të ndjekë relatori i çështjes për realizimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për një pozicion të lirë, të cilat zhvillohen krahas me procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të emërimit, të pasurisë dhe të figurës për të gjithë kandidatët për atë pozicion të lirë. Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për një pozicion të lirë, përfshihen vetëm kandidatët e kualifikuar për t’u emëruar me vendim përfundimtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në përfundim të verifikimeve për të gjithë kandidatët në procedurën e përzgjedhjes për emërim në një pozicion të lirë, relatori njofton Kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve, projektvendimin paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve. Seksioni B, rregullon fazën e shqyrtimit dhe të miratimit nga Komisioni të projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve. Ndërsa, Seksioni C rregullon fazën e shqyrtimit dhe të miratimit nga Këshilli të projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, si dhe të listës me kandidatët më të mirë. Seksioni Ç rregullon fazën e intervistimit nga Këshilli të kandidatëve të listuar më mirë, të cilët njoftohen për vendin, ditën dhe kohën e paraqitjes për intervistë, në një seancë dëgjimore, në mbledhjen e Këshillit. Njoftimi përmban edhe udhëzimet lidhur me natyrën dhe kohëzgjatjen e intervistës. Këshilli, kur ka vendosur thirrjen e ekspertit, e njofton atë për vendin, ditën dhe kohëzgjatjen e shërbimit të kërkuar. Njoftimi përmban edhe udhëzimet e Këshillit lidhur me natyrën e çështjes, sikundër përmban edhe sa i përket edhe ekspertit të thirrur në Komision, si dhe çështjet që mund të pyeten nga anëtarët. Ndërsa, Seksioni D përcakton rregulla të detajuara në lidhje me fazën e shqyrtimit dhe miratimit nga Këshilli të projektvendimit përfundimtar të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, si dhe të projekt-aktit të propozimit për emërim. Vendimi i Këshillit për propozim për emërim, që ka marrë formë të prerë sipas

ligjit, i dërgohet menjëherë Presidentit të Republikës. Në rastin kur Presidenti i Republikës dekreton mos emërimin në Gjykatën e Lartë të kandidatit me renditjen më të lartë, në projektvendim është parashikuar se ky Dekret shqyrtohet nga Këshilli, jo më vonë së një javë nga depozitimi i tij pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Dekreti i Presidentit të Republikës për mos emërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij voton shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, pra jo më pak se 6 (gjashtë) anëtarë të tij. Në hipotezën që Dekreti i Presidentit të Republikës mbetet në fuqi, është parashikuar se Këshilli, në të njëjtën mbledhje, vendos për rihapjen e procesit të kandidimit të jo-gjyqtarëve për atë pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë ose propozon për emërim kandidatit e renditur i dyti më lart, propozim ky që i dërgohet menjëherë Presidentit të Republikës.

Së fundmi, në Kreun VII, titulluar “Zbatimi me analogji i vendimit”, projektvendimi parashikon se kriteret për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve të parashikuara në këtë vendim zbatohen, për aq sa gjejnë zbatim, edhe për ato procedura të përzgjedhjes së kandidatëve që rregullohen nga ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe që referojnë drejtpërdrejtë ose tërthorazi në nenin 49 të tij, konkretisht në procedurat që lidhen me:

a) caktimin në pozicion të ish-gjyqtarëve të riemëruar sipas nenit 36, referuar nenit 39, pika 4, shkronja “a”, të ligjit të Statusit;

b) lëvizjen paralele të ish-gjyqtarëve të riemëruar sipas nenit 36, referuar nenit 43, pika 8, shkronja “b” dhe pika 9, të ligjit të Statusit;

c) zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve të komanduar, referuar nenit 53, pika 11 të ligjit të Statusit;

ç) caktimin në pozicion të ish-gjyqtarëve të riemëruar sipas nenit 166, referuar pikës 5 të kësaj dispozite, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

Bashkëlidhur projektvendimit është Shtojca për “Kriteret e vlerësimit dhe të dhënat metodologjike për pikëzimin e kandidatëve jo-gjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”, e cila përcakton në mënyrë të hollësishme ndarjen e kritereve, listën e treguesve që mund të merren parasysh në secilën kategori të kritereve, pikëzimin maksimal të secilës prej tyre,

si dhe burimet dokumentare dhe metodën e vlerësimit të kandidatëve jo-gjyqtarë që do të propozohen për t'u emëruar për në Gjykatën e Lartë.

Së fundmi, në projektvendim parashikohet që ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky ishte pak a shumë relacioni i përgatitur nga ana e Komisionit, ndërkohë që të gjithë anëtarët e Komisionit janë përfshirë që më herët në procesin e draftimit të këtij projektvendimi. Komisioni ka konsideruar pjesën më të madhe të sugjerimeve të bëra nga anëtarët dhe ato janë reflektuar në projektvendimin që ju keni për shqyrtim. Gjithsesi, gjithkush është i hapur për komente apo për të drejtuar pyetje për çështje të caktuara. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, jeni të hapur për diskutime, komente apo sugjerime lidhur me përmbajtjen e projekt-aktit. Unë dua edhe një herë të theksoj që ashtu sikurse e tha edhe zoti Toska, ky projekt-akt është një projekt-akt mjaft i rëndësishëm dhe i është nënshtruar një konsultimi si brenda institucionit, ashtu edhe me partnerët ndërkombëtarë. Kështu që, nëse ju keni ndonjë sugjerim gjatë gjithë këtij procesi që u bë në hartimin e projekt-aktit, të lutem, jemi të hapur...

Po, zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Atëherë, në lidhje me aktin që sot diskutojmë, unë desha të parashtroj që është e disata herë edhe nga praktika që është krijuar në këtë Këshill, kemi të bëjmë me një diskutim shumë të gjerë, të një periudhe shumë të gjatë kohore që bëjmë në takimet tona, për të reflektuar të gjitha ato mendimet dhe objeksionet tona në akt, të cilat janë reflektuar tashmë. Ne kemi kohë që kemi punuar të gjithë bashkë, por unë këtu gjej rastin në fakt të falënderoj grupin e punës, pra Komisionin e Karrierës, të cilët kanë bërë një punë shumë voluminoze dhe shumë të saktë, për mendimin tim, dhe kanë pranuar të gjitha gjetjet edhe të anëtarëve të tjerë, nëpër ato raste që ka patur nevojë për t'u ndërhyrë.

Shkurtimisht unë doja të thoja që ky projekt-akt është një nga vendimet më të rëndësishme që ka marrë ky Këshill dhe kjo është në fakt në zbatim të reformës në drejtësi dhe mund të jetë ndër aktet e para që do ketë impaktin e zbatimit të kësaj

reforme. Jemi të gjithë koshient se si ka qenë situata në emërimet në këtë gjykatë, në këto nivele dhe jemi koshient që e gjithë kjo reformë që u bë, u bë në lidhje për të rregulluar disa situata të pakëndshme po themi dhe në këtë kuadër është reflektuar në paketën ligjore që është paraqitur. Gjithashtu, në lidhje me statusin, në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” (ligji 96/2016), në nenin 49 janë përcaktuar të gjitha kriteret e emërimit të kandidatëve jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë. Pra ajo që ka ky projekt-akt është ajo që parashikon edhe ligji në vetvete, që parashikon edhe pikëzimin, parashikon edhe të gjitha kriteret që duhet të plotësojë një person që aplikon për një pozicion të tillë.

Duke patur parasysh edhe Shtojcën bashkëlidhur këtij akti pra, që është pikëzimi, është më ‘feir’ (*fair*) po themi, për këdo që aplikon, që në fund të fundit, në fund të ditës e gjen veten dhe sheh pikëzimin, sheh pjesën se ku ndodhet dhe ky pikëzim nuk ka asgjë subjektive, por thjesht është ajo që vjen nga puna e tij, nga të gjitha vlerësimet që ai ka marrë.

Unë nuk kam gjë tjetër për të shtuar, thjesht mbështes këtë akt, se në fund të fundit është vetëm zbatimi i ligjit dhe konkretisht i nenit 49 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Hallunaj!

Kërkon ndonjëri nga anëtarët fjalën?

Okej, zonja Ukperaj! Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Faleminderit!

E gjithë procedura e emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë e parashikuar në ligj është e ndarë në dy kategori: pozicionet e gjyqtarëve që vijnë nga brenda sistemit dhe pozicionet e gjyqtarëve që vijnë nga jashtë sistemit, të cilët Kushtetuta i parashikon si juristë të spikatur. Për shkak të mënyrës së si ligji e ka konceptuar procedurën e gjetjes së këtyre, pikërisht, juristëve të spikatur, procesi i draftimit ka qenë një proces i vështirë që është përfunduar në fazë të parë me rregulloren e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për secilin kandidat dhe në varësi të vendimit të kualifikimit ose jo fillon efektet të zbatojë kjo rregullore e dytë që ka të bëjë pikërisht me vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen. Rregullorja është shumë e rëndësishme sepse të paktën, për sa eksperiencë kam unë në gjyqësor, është një rregullore që për herë të parë, në mënyrë objektive, transparente dhe

sipas meritokracisë, bën një renditje të kandidatëve, pikërisht sipas 3 kriterëve kryesore të përcaktuara në rregullore, që janë: vlerësimi i aftësive profesionale; meritave morale dhe; aftësive të tyre organizative dhe menaxheriale.

Draftimi i rregullores është jo vetëm neni 49, por është një pasqyrim edhe i asaj çka ligji ka lejuar Këshillin të miratojë rregulla më të hollësishme për sa i përket kriterëve të renditjes sepse në nenin 49 përcakton vetëm parimet kryesore.

Ka qenë shumë e vështirë sepse edhe ne e kemi ndjekur nga afër punën e Komisionit të Karrierës, që të përcaktojmë pikërisht cilët do jenë këto indikatorë vlerësues të secilit kriter. Rregullorja ka përcaktuar, bashkë me shtojcën bashkëngjitur, por që do të bashkëngjitet gjithashtu edhe një metodologji e përcaktimit, ka të përcaktuar në mënyrë të qartë të gjitha kriteret mbi të cilat Komisioni por edhe Këshilli do të mbështetet për përzgjedhjen e kandidatëve.

Çka është e rëndësishme dhe risi që sjell kjo rregullore dhe që duhet t'i bëhet e ditur të tjerëve: Procesi i emërimit të kandidatëve jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, përfundon me një akt emërimi/propozim për emërim që Këshilli ia dërgon Presidentit të Republikës. Për të arritur në këtë akt emërimi, puna fillon në Komision dhe përfundon në mbledhjet e Këshillit, ku Këshilli ka rol aktiv në pikëzimin e kandidatit. Pra, Komisioni kryen të gjithë punën dhe gjithashtu edhe relatori kryesisht i çështjes, për të vlerësuar kandidatin sipas kriterëve të parashikuara në këtë rregullore, ndërton një sistem pikëzimi, por është Këshilli ai për efekt të miratimit të atyre 5 listës së kandidatëve më të mirë mes të cilëve do të zhvillojë edhe seancën dëgjimore në Këshill, përcakton edhe pikëzimin.

Ky pikëzim nuk është pikëzim përfundimtar por është një pikëzim që i nënshtrohet përsëri një verifikimi nga ana e Këshillit, pasi të dëgjojë në seancë dëgjimore edhe vetë kandidatët.

Pra në vlerësimin tim, rregullorja është ezauruese jo vetëm në aspektet procedurale por edhe në aspektet materiale të vlerësimit që duhet të bëjë Këshilli në gjetjen, pikërisht të juristit më të spikatur.

Prandaj është edhe nga ana ime një falënderim i madh edhe për Komisionin e Karrierës për punën që ka bërë në hartimin e rregullores dhe të gjithë kolegëve që kemi qenë pothuajse të angazhuar dhe koherent me çdo gjetje të Komisionit.

Misionet ndërkombëtare, -gjithashtu, po! Ju falënderuan dy herë. Herën e tretë do dukeshe shumë.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Po, zoti Medi!

Medi Bici: Meqenëse unë jam përfaqësuesi i Gjykatës së Lartë në këtë Këshill, edhe unë po i them mendimet e mia shkurt. Jam i të njëjtit mendim me dy anëtarët e tjerë. Puna që ka bërë Komisioni i Karrierës është një punë shumë e mirë dhe punë e madhe. Vetëm ne si anëtarë kemi punuar 2-3 ditë, dhe me kohë të zgjatur, për t'i parë, për t'i reflektuar ato ndryshime dhe ato mendime që kam thënë unë janë të pasqyruara në ndryshimet që ka bërë së fundmi Komisioni i Karrierës.

Mendoj që ligjet e reja 2 risi sjellin, është e para, që gjyqtarët e lartë propozohen nga Këshilli për çdo pozicion, pra civil, administrativ ose penal. Dhe risia tjetër është renditja e tyre në bazë të pikëzimit. Ne tani, sot miratojmë dy akte. Njërin e kemi miratuar më përpara. Dhe akti i katërt që e mbyll këtë cikël është metodologjia, -siç e tha dhe zonja Brikena.

Por jam i mendimit që duhet bërë shumë kujdes në aktin e më pasmë që vijmë, të metodologjisë, për të treguar qartë, ndarjet e pikëzimit, diferencat që bëjmë në vlerësime se do të jenë shumë të rëndësishme dhe shikoj që edhe ligji për statusin e gjyqtarëve si dhe ligji për organizimin gjyqësor shprehen për ndarjen e Gjykatës së Lartë në 3 kolegje: civil, penal dhe administrativ. Tregon edhe mënyrën se si zgjidhen kryetarët e këtyre kolegjeve por nuk e shpreh se kush i ndan, kush i ndan kolegjet? Që ligji i mëparshëm për organizimin e Gjykatës së Lartë, kjo detyrë ka qenë e Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Prandaj mendoj që duhet të bëjmë shumë kujdes kur të hapim vendet vakante, për t'i baraspeshuar të gjitha, për të qenë numri i barabartë i anëtarëve në kolegje, se më mbrapa mund të na lindë vështirësi kalimi nga kolegji administrativ në kolegjin civil, nga kolegji civil në kolegjin penal, me pretendimin e gjyqtarëve që në jemi të specializuar në këto fusha. Gjithashtu, ajo që tha edhe zonja Brikena, mendoj që akti që do vijë më mbrapa do na bëjë ne që ne të shkojmë tek juristi i spikatur. Metodologjia dhe pikëzimi do të na çojë që ne të gjejmë juristin e spikatur. Edhe njëherë falënderoj Komisionin dhe nuk kam ndonjë kundërshtim për aktin në tërësi.

Naureda Llagami: Po, zoti Qoku!

Maksim Qoku: Edhe unë diçka në fakt. Faleminderit!

Unë nuk do desha të bie në përsëritje për falënderimet, sepse ne e dimë të gjithë sa jeni lodhur, kështu që prezumohet një fakt i tillë. Thjesht desha të jap një opinion në lidhje me faktin që vet kam qenë gjithmonë skeptik në aspektin e hartimit të akteve përtej ligjit në sqarim ose në përcaktim kriteresh të mëtejshëm sepse e kam thënë është ai raporti i prishjes midis raportit objektiv dhe subjektiv çka ligji thotë dhe çka kriteret që mund të përcaktohen, bëhen të natyrës subjektive. Dhe natyrisht këtë gjë e kam parë, për nga natyra që përcaktohen kriteret, tek akti në fjalë. Por të gjitha vërejtjet që unë personalisht kam bërë i kam parë të pasqyruara, çka do të thotë, jemi marrë vesh, jemi mirëkuptuar dhe kemi shkuar drejt asaj që ne insistojmë, objektivitetit. Megjithatë në tërësi duke pasur gjithmonë frikën e zbatimit të asaj çka na vjen më pas, gjithmonë është ajo që zoti Bici tha, ne duhet të jemi të kujdesshëm tashmë në zbatimin e këtyre sepse shpeshherë, shumë kriteret e ruajnë natyrën subjektive dhe shpeshherë na humbin midis natyrës së përcaktimit dhe mënyrës se si ne duhet të përcaktojmë pikë-avarazhin, ndaj pas këtij momenti, unë do të isha për faktin që t'i jepnim pak rëndësi metodologjisë që të mund të ishim konkret dhe shpeshherë, natyrisht dhe pa dashje jo abuziv, që të arrinim tek juristi më i mirë i spikatur dhe të vlerësonim më drejtë në lidhje me pikë-avarazhin në tërësi.

Kështu që për sa çka opinionesh kam dhënë janë marrë parasysh dhe për sa e gjykoj që akti në tërësi është më të vërtetë i plotësuar, nuk kam çfarë shtoj gjë tjetër, vetëm atë që theksova që ne duhet të kemi parasysh që në të ardhmen, sidomos me metodologjinë, të jemi shumë më konkret dhe më të kujdesshëm. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Qoku!

Ndonjë sugjerim? Po!

Brunilda Kadi: Faleminderit!

Atëherë përveç konsideratave të përgjithshme, nuk po përsëris kolegët, jam dakord pothuajse me të gjitha. Mendoj se ndoshta duhet në qoftë se ka dikush, unë kisha diçka për të diskutuar, për një pjesë e një dispozite që unë nuk jam dakord. Siç u tha nga të gjithë, ne këtë e kemi diskutuar të gjithë në grup dhe pothuajse për të gjitha situatat

kemi rënë dakord. Aty ku s'kemi rënë dakord e lamë që do e diskutojmë në mbledhjen plenare dhe do hidhet me votë. Kolegët të gjithë argumentin që do të them unë sepse është thënë dhe stërthënë, por për respekt të mbledhjes dhe për ata që e dëgjojnë, thjesht do përsëris argumentin.

Tani po hyj në detaje të rregullores, tek pjesa.... Për aq sa mund të na kuptojnë të tjerët, nuk e di, por kur ta them ndoshta do kuptohet. Tek pjesa D “Shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projekt-aktit përfundimtar të vlerësimit”, në pikën 8, kur parashikohet mundësia që kandidatët vlerësohen me barazi pikësh. Është për t'u thënë kjo që, domethënë ne pretendojmë të jemi aq objektiv sa do t'i kemi kandidatët me pikë të barabarta dhe kjo i bie që të jetë një arritje shumë e madhe, dhe tek rregullorja tek pika 9, është parashikuar ajo që thotë ekzaktësisht ligji, që në këto raste t'i jepet prioritet kandidatit që ka eksperiencë profesionale më të gjatë. Pra, nëse dy kandidatë do të vijnë me pikë të barabarta, ai që ka eksperiencë - sepse pikët do t'i kenë marrë nga situatë të ndryshme - do prevalojë eksperiencë profesionale. Tek kjo pikë është shtuar një rregull që unë personalisht mendoj që nuk e ka ligji, dhe thuhet “...Në rast se, edhe mbas kësaj barazie mes kandidatëve, - pra mundet çuditërisht që ata të jenë emëruar në një ditë dhe të kenë të njëjtën vjetërsi profesionale, -atëherë renditja e tyre do përcaktohet nga njohuritë e gjuhës së një shteti anëtar të Bashkimit Evropian. E kemi diskutuar stërdiskutuar. Ligji... ashtu e ka vlerësuar legjislatori, i ka dhënë një lloj prioriteti kandidatit që di një gjuhë të huaj të Bashkimit Evropian. Unë personalisht e kam shprehur, mbase të gjithë kemi rënë dakord që është pak si jo dhe aq e pranueshme që të vlerësosh një gjyqtar të Gjykatës së Lartë sepse di apo s'di një gjuhë të huaj, kur pozicioni i tij është për të tjera gjëra. Por që normalisht po, prezumohet që duhet ta dijë sepse është një kriter skualifikues nëse nuk ka një doktoraturë, por gjithsesi në kushtet/në kohën që jetojmë sot, nuk e di, gjuha e huaj si mund të jetë vlerë e shtuar?! Megjithatë, e ka vënë ligji dhe ne për këtë arsye, tek metodologjia, tek pikëzimi, i kemi dhënë pikë gjuhës së huaj (deri në 4 maksimumi). Që unë dhe për këtë kam propozuar që të ishte 3, gjithsesi rashë dakord që të ngelet 4 (kur shkojmë tek tabela e ndarjes). Por, vendosja e këtij kriteri, përsëri prioriteti, përveçse është përtej ligjit, ka dhe një problem alogjik sepse i jepet dy herë vlerë kësaj gjëse që unë sapo e shpjegova që për mua nuk duhet të

ishite por që është tani. Kjo është alogjike sepse asnjë lloj kriteri nuk mund t'i jepet dy herë vlerë. Sepse një herë vlerë i jepet kur ti i jep ca pikë. Atij që di, i jep maksimumi 4 potencialisht, dhe atij që s'di i bie që të marrë 0 pikë. Pra ata diferencohen që në këtë moment me 4 pikë. Ti nuk mund t'i japësh përsëri vlerë gjuhës në qoftë se ata shkojnë me barazim.

Kështu që unë propozoj, që mos të zgjatemi, që kjo fjalë e dytë e pikës 9, të hiqet. Dhe nëse do ketë barazi edhe në këto kushte, që i bie të jenë kushte laboratorike, që të dalin dy kandidatë ekzaktë me të njëjtën pikë dhe me të njëjtën ditë që janë emëruar në punë, unë mendoj që gjeja më e ndershme është që ata të përcaktohen me short. Është gjëja më e pranueshme që nuk cenon askënd. Pra, ramë dakord që këto dy kandidatët qenkan identikë, edhe në profesion janë identik. Atëherë ne nuk mund të kemi një kriter ekstra procedural. Ta lejmë me short ose ta pranojmë që s'mund të ndodhë një rast i tillë. Se po të vazhdojmë kështu... se mund të ndodhë që dhe në gjuhë të jenë identik ata. S'mbaron pastaj. Ngelemi si rreth vicioz. Po sikur dhe gjuhët t'i dinë njëlloj ata? Si i bëhet? Ngelemi prapë pa zgjidhje. Ose siç e përdor unë atë batutën, është 'x' prapë, iks domethënë.

Kështu që propozoj që të hiqet kjo, dhe ta hedhim në votë që mos e diskutojmë sepse me njëri-tjetrin e kemi diskutuar. I kërkoj Kryetares ta hedhë në votë propozimin tim që kjo pikë të hiqet nga pika 9. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit për komentin dhe për sugjerimin konkret. Po ia kaloj fjalën zotit Toska, për të dhënë sqarimet e nevojshme mbi propozimin.

Ilir Toska: Për të njëjtën arsye që zonja Kadi prezantoi në mbledhje në kundërshtim të asaj, në lidhje me vendosjen si kriter për renditjen e gjuhës së huaj, të një vendi të Bashkimit Evropian, dua të bëj dhe unë të njëjtin koment, që e kemi diskutuar të gjithë bashkërisht. Komenti im i vetëm është që tek pika 3, neni 49 i ligjit përcaktohet qartësisht se, kandidati që ka njohurinë e një gjuhe të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian, ka përparësi në vlerësim. Është pikërisht kjo arsyeja që Komisioni konsideroi që ta përcaktojë këtë gjë si kriter për renditjen e kandidatëve me pikë të barabarta. Nëse kjo iu duket oportune, të gjithë anëtarëve të Këshillit, është çështje e të gjithëve. Por

komenti im i vetëm, sa i përket ligjit është kjo, dhe ligji na jep të drejtën që të vendosim kritere për renditjen. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Po, zoti Muharremaj!

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Në vijim të kësaj që sapo tha zoti Toska, unë desha të shtoj që, si kriter ndarës për të përcaktuar midis dy kandidatëve që kanë vlera të njëjta, e gjykoj me vend propozimin për t'u bërë diferencim nëpërmjet njohurive të gjuhëve të huaja dhe posaçërisht të atyre të vendeve të Bashkimit Evropian, nisur dhe nga fakti edhe për rëndësinë që ka i gjithë procesi i integritimit i Bashkimit Evropian për vendin tonë. Përparësia nuk vjen vetëm nga fakti i njohjes së gjuhës në vetvete, por për shkak se i mundëson një kandidati të tillë, shfrytëzimin e literaturës, njohjen më të thellë të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e kështu me radhë. Ndaj gjykoj që propozimi i Komisionit është i drejtë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zoti Bici!

Medi Bici: Diskutimi që jep zonja Brunilda është që, jo mos të cilësohet gjuha, por gjuha merr dy herë pikë. Dhe ky është për t'u marrë në diskutim.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Merr pikë dy herë, merr pikë dhe tek pjesa e gjuhës, por merr pikë edhe këtu. Duhet të gjejmë një indikator tjetër që mos të vlerësohet dy herë.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Naureda Llagami: Zonja Kadi me mikrofon të lutem sepse është diskutim.

Ilir Toska: Ligji i ka dhënë autorizimin Këshillit të përcaktojë kriteret në rastin e pikëve të barabarta. Ndërkohë që ligji ka konsideruar në mënyrë të posaçme që kandidati që njeh një gjuhë të Bashkimit Evropian ka përparësi, konsideruam që ky duhet të shërbejë edhe si kriter për renditjen, ndryshe do të duhet të krijojmë një kriter tjetër. Ndërkohë që ligji në mënyrë eksplicite konsideron posaçërisht një gjë të tillë.

Medi Bici: Zoti kryetar edhe në këtë pikë i ke dhënë dy herë, sepse një që ka një gjuhë tjetër i ke dhënë më pak pikë kurse ai që ka një gjuhë të KE i ke dhënë pikë më shumë, pra i bie vlerësimi ta vlerësosh tre herë.

Ilir Toska: Për sa kohë ligji i konsideron si përparësi, nuk mund ta injorojmë këtë gjë. Fakti që ligji kërkon përparësi, e konsideron përparësi në vlerësim dhe e gjithë gjëja që bëhet nëpërmjet pikëzimit, është vlerësim. përfshirë edhe renditjen. Pikëzimi dhe renditja është në tërësi një vlerësim.

Brunilda Kadi: Okej, mund të shtoj diçka. Meqenëse u përmend kjo dispozita. Atëherë që të jemi konkret, tek neni 49, pika 3 e dispozitës thotë: "...kandidati që ka njohuritë të një gjuhe të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian ka përparësi në vlerësim", që do të thotë që për shkak të këtij urdhërimi të ligjit, ne i dhamë pikë gjuhës, sepse në qoftë se nuk do ishte kjo, gjuha nuk do ishte fare kriter vlerësimi. Pra ne ja dhamë prioritetin në vlerësimi. Tani kur pjesa e posaçme e dispozitës që flet kur kemi barazi, e thotë qartazi dhe nuk lë asnjë ekuivok, kur thotë 'në barazi pikësh vlerësohen vitet e eksperiencës'. Ku e gjeni ju që futet dhe gjuha? Që ta vazhdoj, -sepse mbas fjalës së zotit Muharremaj, -tani i bie që qëllimi jonë nuk është të gjejmë juristin më të spikatur por të gjejmë atë, si quhet, linguistin më të mirë? Pastaj, ku është ky ekspert që do na i ndaka...?

Dhe unë e ngrita pyetjen, - Po sikur të dy të na rezultuakan identikë edhe në gjuhë? Atëherë i bie që anëtarin e Gjykatës së Lartë do na e zgjedhka një person akademik që do na e ndaka se kush di më mirë gjuhën e Bashkimit Evropian. Dhe unë e them më forcë që jam kategorikisht kundër kësaj sepse kjo është një pikë shumë e rëndësishme.

Naureda Llagami: Zoti Toska dhe mos e zgjasim sepse e hedhim në votim.

Ilir Toska: I kemi ezauruar bashkërisht të gjithë këto debate por efekt të mbledhjes.

Fakti që gjuha e huaj merr pikë është e përcaktuar në pikën 6 të neni 49, kështu që jemi të detyruar që ta respektojmë rigorozisht këtë pjesë të ligjit. Pika 3 nuk ka lidhje me pikën 6. Pika 3 është një dispozitë e veçantë që flet për përparësinë në vlerësim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, si doni të procedojmë, të kalojmë njëherë në votim propozimin e zonjës Kadi? Atëherë zonja Kadi, keni një propozim konkret? Mund ta lexoni edhe njëherë çfarë propozoni, sugjerimin tuaj?

Brunilda Kadi: Tek pjesa D, tek pika 9, të hiqet fjalia e dytë, të hiqet fare “...në rast se edhe pas kësaj del barazi mes kandidatëve, renditja e tyre përcaktohet nga njohuritë e gjuhës së një shteti anëtar të Bashkimit Evropian”, të hiqet fare. Shortin hajde ta diskutojmë. Unë jam me mendimin që s’do ketë nevojë për short sepse i bie që domethënë...

Naureda Llagami: Të lesh vetëm fjalinë e parë?

Brunilda Kadi: Po, vetëm fjalinë e parë, aq sa thotë ligji. Ky është propozimi im.

Naureda Llagami: Atëherë hedhim në votë propozimin e zonjës Kadi lidhur me pikën 9, duke hequr fjalinë e fundit të këtij paragrafi?

Maksim Qoku: Pro.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

(6 vota kundër, 5 vota pro.)

Më falni, kalojmë tek miratimi i projektvendimit. Kemi ndonjë koment, ndonjë sugjerim, për ndonjë nen konkret?

Atëherë kalojmë tek miratimi i projekt-rregullores? Jemi dakord me tekstin?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli miratoi projektvendimin “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërimin në Gjykatën e Lartë” sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 05.07.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve për secilin kandidat për gjyqtar të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:09 dhe mbaroi në orën 12:42.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
7. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
8. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Edlira Bako, Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
10. *Marjana Papa, OSCE.*
11. *Klodian Rado, EURALIUS.*
12. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
13. *Ervin Karamuço, ISP.*
14. *Klara Kodra, Qendra Evropiane.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve për secilin kandidat për gjyqtar të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019”.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës.

Atëherë, lidhur me çështjen e dytë të rendit të ditës, kemi të bëjmë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e relatorit për verifikimin e kushteve dhe kriteret për secilin kandidat për gjyqtar të diplomuar të Shkollës së Magjistraturës për vitin 2019”.

Ashtu sikurse kemi vepruar edhe me kandidatët e mëparshëm, Shkolla e Magjistraturës nëpërmjet shkresës nr. 625, datë 03.07.2019 na ka dërguar pranë Këshillit

vendimin e saj për diplomimin e 15 studentëve të rinj që kanë përfunduar studimin në vitin 2019. Për të bërë emërimin e tyre në detyrë, ligji ka parashikuar, që fillimisht duhet të bëhet verifikimi i pasurisë dhe i figurës, proces ky që është rregulluar nga KLGJ-ja, nëpërmjet vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, në të cilën parashikohet se procesi i verifikimit duhet të bëhet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, konkretisht nga relatori që është anëtar i këtij Komisioni dhe që caktohet me short.

Atëherë për të vazhduar në procedurën e shortit, thjesht për t’jua shpjeguar se si do veprohet në këtë lloj procedure dhe sikurse kemi vepruar dhe në rastet e tjera, procedura që ndjek Këshilli është që shorti do të organizohet duke futur në dy vazo qelqi të palosura shirita letra, ku në njërin vazo do të vendosen emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, konkretisht z. Ilir Toska, znj. Marçela Shehu dhe z. Alban Toro pra 3 shirita letre, ndërkohë që në vazën tjetër do të jenë emrat e 15 kandidatëve për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019, që rezultojnë të jenë:

{...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Punonjësi i administratës që është këtu prezent në sallë, do tërheqë një shirit letre nga vazojat në të cilën ndodhen emrat e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës dhe lexon me zë të lartë emrin që është shkruar, ndërkohë tërheq edhe një shirit letre nga vazojat në të cilën janë emrat e anëtarëve të Komisionit dhe e lexon dhe atë me zë të lartë. Ky anëtar i Komisionit që konsiderohet i zgjedhur nga shorti, përcakton qenien e tij relator për të diplomuarin.

Për shkak se, anëtarë të Komisionit janë tre anëtarë ndërkohë, kandidatët janë më shumë, pas përcaktimit relator të tyre, shiritat e letrës me emrat e tyre rifuten përsëri në vazo duke rifilluar procesin e caktimit të tyre si relator deri në përfundimin dhe caktimin të secilit kandidat të relatorit përkatës.

Po Zoti Toska!

Ilir Toska: Ne si Komision sugjerojmë, kemi propozimin që bërë mes nesh, një ndarje të punës, nga 15 kandidatë që do duhet të verifikohen, unë si kryetar të marrë 3 prej tyre për verifikim, ndërsa dy anëtarët e tjerë të Komisionit nga 6 secili.

Naureda Llagami: Faleminderit për propozimin! Jemi dakord për propozimin e bërë nga kryetari i Komisionit?

Dakord.

Atëherë, të vijohet me hedhjen e shortit duke marrë parasysh propozimin e bërë nga zoti Toska. Faleminderit!

Elis Kuçi: Atëherë si fillim janë emrat e anëtarëve të Komisionit: zoti Alban Toro, zoti Ilir Toska dhe zonja Marçela Shehu.

Tani vëmë emrat e kandidatëve: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Atëherë emri i kandidatit është {...} që u përzgjedh i pari.

Anëtari Ilir Toska.

Ilir Toska: Propozoj që të përzgjidhen dhe dy kandidatë të tjerë, meqenëse emri im u tërhoq i pari, që të mbyllet procedura sa i përket kandidatit që unë duhet të jem relator.

Naureda Llagami: Dakord.

Elis Kuçi: {...}, {...}.

(Pra relatori Ilir Toska për kandidatët {...}, {...} dhe {...}.)

Kandidati {...}. Marçela Shehu.

{...}, {...}, {...}, {...}, {...}, e fundit.

(Relatore Marçela Shehu për kandidatët {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.)

Kandidatët e tjerë janë për anëtarin Alban Toro - {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Këtu përfundoi shorti.

Naureda Llagami: Në vijim të shortit të hedhur, Këshilli vendosi, caktimin e relatorit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve për secilin kandidat për gjyqtar, të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019, si më poshtë, -po i lexoj me radhë:

1. {...}, relator zoti Alban Toro.
2. {...}, relator zoti Alban Toro.
3. {...}, relator zoti Alban Toro.
4. {...}, relator zonja Marçela Shehu.
5. {...}, relator zonja Marçela Shehu.

6. {...}, relator zoti Alban Toro.
7. {...}, relator zonja Marçela Shehu.
8. {...}, relator zoti Ilir Toska.
9. {...}, relator zoti Alban Toro.
10. {...}, relator zonja Marcela Shehu.
11. {...}, relator zoti Alban Toro.
12. {...}, relator zonja Marçela Shehu.
13. {...}, relator zoti Ilir Toska.
14. {...}, relator zonja Marçela Shehu.
15. {...}, relator zoti Ilir Toska.

Kalojmë në votim sa më sipër?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 05.07.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:09 dhe mbaroi në orën 12:42.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Marjana Papa, OSCE.*
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 12. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 13. Ervin Karamuço, ISP.*
- 14. Klara Kodra, Qendra Evropiane.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e tretë e rendit të ditës.

Atëherë në çështjen e tretë të rendit të ditës, kemi të bëjmë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidaturë në radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit në këtë pozicion”. Ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, pra është një akt i përbashkët. Për ta relatuar këtë akt, po ia jap fjalën kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Sikundër dhe ju relatuat, nevoja për hartimin e këtij projektvendimi për miratimin e tij në mbledhje plenare ka lindur nga domosdoshmëria e plotësimit të stafit mbështetës për çdo komision, nëpërmjet kandidaturave nga ana e gjyqtarëve, kemi vlerësuar, për 4 pozicione, 2 pozicione në Njësinë mbështetëse të Komisioneve të Përhershme dhe 2 pozicione në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve.

Kemi vlerësuar që për shkak të natyrës së punës që duhet të ketë stafi mbështetës dhe përbërës të këtyre Komisioneve dhe për shkak dhe të mundësive sepse nuk kemi mundësi të marrim më shumë gjyqtarë, të shpallim kandidaturat për komandim të gjyqtarëve në 2 pozicione në Njësinë mbështetëse të komisioneve dhe 2 pozicione për gjyqtarë në Komisionin e Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional.

Duke qenë se në këtë rast Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk është vetëm organi që realizon procedurën e komandimit të gjyqtarëve, por është edhe organi që ka nevojë për gjyqtarë në strukturën e tij, në këtë vendim, veç shpalljes së kandidaturës së kërkesës për komandim, janë parashikuar dhe kriteret e përgjithshme dhe kriteret specifike që janë të nevojshme për pozicionin e kërkuar.

Si kriter i përgjithshëm janë ato kriteret të komandimit të parashikuara në nenin 53, pra që komandimi nuk mund të lejohet në rastin kur gjyqtari është i komanduar apo është në një pozicion me mandat të kufizuar, janë pikërisht të parashikuara në kreun 2, “Kohëzgjatja, kriteret e komandimit”, por janë parashikuar disa kriteret specifike të cilat janë evidentuar si përparësi të kandidatit që i plotëson këto kriteret. Konkretisht, ekspertiza e veçantë në fushën e hartimit të akteve rregullatorë; njohuri mbi legjislacionin

e vendeve të Bashkimit Evropian, dhe atë ndërkombëtar, jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor; qenien autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës; njohuri shumë të mira e të paktën të një gjuhe të një vendi të Bashkimit Evropian, dhe aftësi shumë të mira personale, organizative dhe personale si etikë e lartë dhe angazhim të vlerave profesionale.

Kohëzgjatja e komandimit është parashikuar të jetë dy vjet, me të drejtën që mund të përsëritet edhe për një kohëzgjatje tjetër deri në 3 vjet, duke qenë se afati kryesor i komandimit është 5 vjet.

Në vazhdim është parashikuar procedura që ndjek Këshilli për realizimin e komandimit. Pas aplikimit të dokumentacionit, Komisioni i Karrierës përgatit një opinion për secilin kandidat duke vlerësuar dëmtimin ose jo sipas rastit, të interesave të gjykatës ku gjyqtari ushtron funksionin dhe pastaj me listën e përgatitur nga Komisioni dhe pasi është marrë edhe votimi në Këshill, do të vazhdohet nga vlerësimi i kandidatëve nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës, i cili bën një renditje dhe ia pasqyron për miratim në mbledhjen plenare, lidhur me kandidatët që vlerëson se plotësojnë kushtet për komandim sipas kriterëve të parashikuara në këtë projekt-akt.

Ky është pak a shumë thelbi i projekt-aktit të cilin ju sot keni përpara për vlerësim. Edhe një herë, 2 pozicionet janë ato “këshilltarit ligjor” në Njësinë Mbështetëse dhe 2 pozicione “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve.

Naureda Llagami: Po, faleminderit zonja Ukperaj!

Të vetmin merak që unë do të kisha në cilësinë e Kryetares, do ishte që ato gjyqtarë që do të përzgjidhen, është që të mbahet kujdes që mos të priset funksionaliteti i gjykatave nga të cilat ato vijnë. Këshilli në këto momente ka shumë nevojë që të ketë staf mbështetës duke marrë parasysh ngarkesën dhe detyrimet dhe përgjegjësitë, që për shkak të ligjit ka.

Nëse keni ndonjë sugjerim konkret, ndryshe kalojmë në votim të projekt-aktit? Po! Faleminderit! Kalojmë në votim.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë projekt-akti miratohet sipas propozimit të bërë nga komisionet përkatëse.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 05.07.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:09 dhe mbaroi në orën 12:42.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
7. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
8. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
10. *Marjana Papa, OSCE.*
11. *Klodian Rado, EURALIUS.*
12. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
13. *Ervin Karamuço, ISP.*
14. *Klara Kodra, Qendra Evropiane.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e listave emërore të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë.

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë në çështjen e tretë të rendit të ditës. Në fakt është çështja e katërt e rendit të ditës, e cila ka të bëjë, me projektvendimin lidhur me miratimin e listave emërore të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020 për pozicionin Këshilltar dhe Ndhimës Ligjor. Projekt-akt i cili është hartuar nga Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhimës Ligjorë dhe do raportohet nga zoti Muharremaj. Faleminderit!

Erjon Muharremaj: Faleminderit! Siç jeni në dijeni, bazuar në nenin 53 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 274 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Shkolla e Magjistraturës organizoi provimin e pranimit për vitin akademik 2019-2020. Në vijim të daljes së rezultateve të këtij provimi, Shkolla e Magjistraturës na është drejtuar me shkresën nr. 508 prot., datë 24.05.2019, duke na njoftuar se, pragu e 175 pikëve e kanë kaluar 40 konkurrentë nga të cilët 5 prej tyre kanë shprehur vullnetin e tyre për të qenë kandidatë për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë. Përveç këtyre, 19 kandidatë kanë kapërcyer pragu e 175 pikëve prej të cilëve 4 plotësojnë kriteret për t’u pranuar si Këshilltarë Ligjorë, ndërsa 9 të tjerë plotësojnë kriteret për t’u pranuar si Ndhimës Ligjorë. Ndërkohë që nuk kanë shprehur kërkesën në formularët e aplikimit për këto profile, për shkak se dëshira e tyre fillestare ka qenë për të konkurruar për gjyqtarë dhe prokurorë. Pjesa tjetër e kandidatëve janë skualifikuar për shkak të mosplotësimit të kriterit të përvojës profesionale i cili është respektivisht 10 vjet për Këshilltarët Ligjorë dhe 5 vjet për Ndhimësit Ligjorë. Në pikën 1/b të vendimit nr. 17 që Këshilli e ka marrë në datën 29.01.2019 mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen për Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2019-2020, ne kemi përcaktuar në këtë vendim se numri i kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhimës Ligjorë, që pas kalimit të testit profesional do të pranojnë për të ndjekur për një periudhë prej 9 muajsh Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2019-2020, është 22, në kushtet që 28 prej tyre janë pranuar për të studiuar në profilin e gjyqtarit dhe të prokurorit.

Në kushtet kur vetëm 5 prej kandidatëve që kanë kapërcyer pragun prej 175 pikëve kishin shprehur fillimisht vullnetin për të filluar studimet për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës kontaktoi përsëri me këta kandidatë që kishin kapërcyer pragun, dhe na rezultoi që dhanë pëlqimin e tyre për të ndjekur studimet për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë për vitin akademik, 4 kandidatë për të studiuar për Këshilltarë Ligjorë dhe 9 të tjerë për Ndhmës Ligjorë.

Në vijim po lexoj listat përkatëse.

Kandidatët për Këshilltarë Ligjorë janë:

1. {...};
2. {...};
3. {...};
4. {...}.

Kandidatët për Ndhmës Ligjorë janë:

1. {...};
2. {...};
3. {...};
4. {...};
5. {...};
6. {...};
7. {...};
8. {...};
9. {...}.

Në vijim ftoj Këshillin, ju kërkoj zonja Kryetare që të ftoni Këshillin të votojë për pranimin e listave për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë për vitin akademik 2019-2020. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit, zoti Muharremaj!

Kemi ndonjë sugjerim, koment?

Jo!

Atëherë e hedhim projekt-aktin në votim sipas propozimit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi të miratojë listën emërore të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në Programin Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020 për Këshilltarë Ligjorë sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi konkretisht:

1. Zonja {...};
2. Zoti {...};
3. Zonja {...};
4. Zoti {...}.

Ndërkohë të miratojë listën emërore të kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020, për Ndhmës Ligjorë, sipas lidhjes 2 bashkëlidhur këtij vendimi, konkretisht:

1. Zonja {...};
2. Zonja {...};
3. Zonja {...};
4. Zonja {...};
5. Zoti {...};
6. Zonja {...};
7. Zonja {...};

8. Zonja {...};

9. Zonja {...}.

Ky vendim hy ne fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 05.07.2019)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarës {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:09 dhe mbaroi në orën 12:42.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|---------------------------------|
| 1. Naureda Llagami | <i>(kryetare)</i> |
| 2. Maksim Qoku | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 3. Medi Bici | <i>(anëtar)</i> |
| 4. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Brunilda Kadi | <i>(anëtare)</i> |
| 6. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Ilir Toska | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 9. Brikena Ukperaj | <i>(anëtar)</i> |
| 10. Erjon Muharremaj | <i>(anëtar)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 6. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 7. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Marjana Papa, OSCE.*
- 11. Klodian Rado, EURALIUS.*
- 12. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 13. Ervin Karamuço, ISP.*
- 14. Klara Kodra, Qendra Evropiane.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarës {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”.

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë sipas rendit të ditës, kalojmë tek diskutimi i projektvendimit lidhur “Për deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit të gjyqtarës {...} për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”. Për më shumë detaje ia kaloj fjalën Komisionit përkatës/përgjegjës, është Komisioni i Karrierës...

Ilir Toska: E ka anëtarja Marçela Shehu.

Naureda Llagami: Okej! Do relatohet nga anëtarja e këtij Komisioni, zonja Marçela Shehu. Faleminderit!

Marçela Shehu: Faleminderit kryetare!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vjen me një propozim për miratimin e projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit të gjyqtarës {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit”.

Znj. {...} me Dekretin e Presidentit nr.4317, datë 17.09.2004 është emëruar gjyqtare dhe është caktuar të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, ndërsa me Dekretin nr. 4655, datë 03.10.2005 është caktuar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Me vendimin nr. 189, datë 28.03.2006 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, znj. {...}, bazuar në kërkesën e saj, është transferuar për të ushtruar funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

Ndërsa në vitin 2010 është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Me shkresën nr. 2497 prot., datë 03.05.2019, gjyqtarja {...}, ka paraqitur një deklaram dhe kërkesë para Këshillit të Lartë Gjyqësor me objekt: Deklarimin e dorëheqjes nga detyra e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës; Deklarimin e dorëheqjes nga funksionet e magjistratit në Republikën e Shqipërisë dhe: Kërkesë për deklarimin prej Këshillit të Lartë Gjyqësor të mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes.

Si shkak të paraqitjes së kësaj dorëheqjeje, znj. {...} ka parashtruar faktin e përfaqësimit të së motrës, përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Duke marrë shkak nga shkak i parashtruar në këtë kërkesë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, iu drejtua znj. {...}, nëse nga ana e saj, kishte një kërkesë që kjo dorëheqje të jepte efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 65 të ligjit nr.96/2016.

Znj. {...} në përgjigjen e saj drejtuar Këshillit, me shkresën nr. 2497/3 prot., datë 23.05.2019, ka konfirmuar deklarimin e saj për heqjen dorë nga detyra e gjyqtarës dhe nga funksionet e magjistratit por ka theksuar se nuk kishte kërkesë të motivuar që efektet e dorëheqjes të fillonin përpara kohës së përcaktuar në ligj.

Më poshtë, ne kemi parashtruar të gjithë parashikimin në kuadrin ligjor që parashikon ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe që rregullon pikërisht institutin e mbarimit të statusit të magjistratit, ku në nenin 64 të këtij ligji parashikohen rastet se ku mbaron ky status, ndër të tjera dhe rasti i dorëheqjes, ndërsa neni 65 i ligjit rregullon pikërisht dorëheqjen si një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit.

Në këto kushte, bazuar në gjitha këto rrethana që Komisioni parashtroi, në lidhje dhe me parashikimet ligjore të neneve 64 dhe 65 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni vlerëson se në rastin konkret jemi në kushtet e mbarimit të statusit të magjistratit të gjyqtarës {...}, për shkak të dorëheqjes së saj paraqitur përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo dorëheqje ka krijuar efekt ligjore më datë 30.06.2019, pra në fund të muajit pasardhës nga dita kur Këshilli ka marrë deklarinimin me shkrim të dorëheqjes, datë 03.05.2019.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit të gjyqtarës {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarës; Efektet ligjore të dorëheqjes fillojnë më datë 30.06.2019. Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Kemi diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar nga Komisioni?

Atëherë e hedhim në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit të gjyqtares {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtares. Efektet ligjore të dorëheqjes fillojnë më datë 30.06.2019. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 05.07.2019)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e limitit të karburantit për automjetet në dispozicion të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:09 dhe mbaroi në orën 12:42.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
7. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
8. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
10. *Marjana Papa, OSCE.*
11. *Klodian Rado, EURALIUS.*
12. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
13. *Ervin Karamuço, ISP.*
14. *Klara Kodra, Qendra Evropiane.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e limitit të karburantit për automjetet në dispozicion të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë të çështja e fundit e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me administrimin e Këshillit, me buxhetin dhe për këtë arsye do të raportohet nga Komisioni i Planifikimit Strategjik (është hartuar projekt-akti) dhe do të raportohet prej meje.

Sikurse jeni në dijeni, neve na është vënë në dispozicion nga Kuvendi, me miratimin e buxhetit, na janë vënë në dispozicion përdorimi i makinave dhe automatikisht

duhet të përcaktojmë dhe numrin dhe sasinë e karburantit që gjithsecili nga anëtarët duhet të përdorë.

Kuptohet që në përmbushje të detyrave të tij, Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron veprimtarinë, ju e dini më mirë, si një organ kolegjal, me 11 anëtarë, dhe shërben me detyrë me kohë të plotë.

Ushtrimi i veprimtarisë së tyre kërkon angazhimin e përditshëm të të gjithë anëtarëve, si brenda institucionit ashtu dhe në takime me organizata, me institucione të tjera, që kanë të bëjnë me fushën e drejtësisë. Kjo veprimtari e anëtarëve kërkon edhe një rregullim të lëvizjes me mjetet e transportit që disponon institucioni për secilin anëtar, të caktimit të një limiti të karburantit për automjeteve në përdorim të tyre.

Rregullimi i transportit për funksionarët publik, në përmbushje të detyrimeve dhe të përgjegjësisë të ngarkuara, për detyrat që ato kryejnë, është i rregulluar me ligjin 10160/2009, i ndryshuar, “Për rregullimin e transportit për funksionarët publik...”, në zbatim të të cilit ka dalë edhe Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 1139, datë 24.11.2009 “Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe shoferëve në dispozicion të ministrive dhe institucioneve qendrore”, i ndryshuar.

Ndërkohë, ju sjell në vëmendje që Gjykata Kushtetuese, me Vendimin e saj nr. 11, datë 06.4.2010, ka shfuqizuar si antikushtetues, pikën 1 dhe 2, të nenit 2, nenin 3, nenin 4 dhe nenin 6, të ligjit të sipërpërmendur, për sa përfshijnë në fushën e zbatimit të tyre, për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, kryetarin e gjykatës së shkallës së parë dhe kryetarin e gjykatës së apelit, si dhe ka shfuqizuar si antikushtetues VKM-në e sipërcituar, për sa përfshin në fushën e zbatimit të tij, Gjykatën Kushtetuese dhe Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

Në këtë situatë ligjore, neve kemi parasysh që ligji nr. 115/2016, në nenin 4, pika 1, thekson se: “Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor ka statusin e magjistratit, sipas rregullave të parashikuara nga ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.”, ndërkohë që në pikën 2 të këtij neni evidentohet që anëtari i Këshillit gëzon pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë”. Pra referuar kësaj dispozite, aktualisht

Kryetari i KLGJ-së dhe anëtarët e KLGJ-së, kanë statusin e Magjistratit dhe gëzojnë pagën dhe përfitimet e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Gjithashtu, po në nenin 95 të ligjit nr.115/2016, ku parashikohet buxheti vjetor i KLGJ-së, ndërkohë që theksohet se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për hartimin e buxhetit vjetor dhe afatmesëm të tij”, dhe në pikën 5, përcaktohet shprehimisht: “5. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për mbikëqyrjen e shpenzimeve, shpërndarjen e fondeve dhe mbajtjen e llogarive të sakta, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë.”

Edhe në nenin 96, po t’i referohemi, në pikën 5, shkronja “b”, e po të njëjtit ligj, theksohet se fondet në dispozicion të Këshillit përdoren, ndër të tjera, edhe për plotësimin e nevojave për shpenzimet operative të Këshillit.

Ndaj sa më sipër, në frymën e të gjithë këtij kuadri ligjor që iu referova dhe duke marrë parasysh që një shpërndarje e drejtë e karburantit do të ndihmonte në mirëfunksionimin normal të punës, propozimi i ardhur, jemi të mendimit që Këshilli i Lartë Gjyqësor të shqyrtojë dhe miratojë, një limit mujor të konsumit të karburantit për çdo automjet në dispozicion të Kryetares dhe Anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili sipas llogaritjeve të kryera (22 ditë punë në muaj, x 60 km, x konsumi për 100 km, 12 litra brenda qytetit të Tiranës, ku rezulton 158 litra në muaj), dhe sugjerojmë që të jetë, si më poshtë: Për automjetin në dispozicion të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, pa limit; Për çdo automjet në dispozicion të Anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, limiti i karburantit të jetë 150 litra, për çdo muaj; Për çdo lëvizje tjetër, jashtë qendrës së punës, për arsye pune të autorizuar nga Kryetarja ose person i autorizuar prej saj, të jetë sipas fletë udhëtimeve të mbajtura, referuar distancave kilometrike ndërqytetëse, të miratuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës. Bazuar në sa më sipër ju propozoj aktin që ju kam vënë në dispozicion.

Maksim Qoku: Vetëm diçka desha të them.

Ju lutem, e kam më shumë për orientim të njëri-tjetrit.

Ajo që konstatoj unë është që e gjithë baza nënligjore është e përpara ligjeve tona, 2016, çka do të thotë që unë shoh shumë herë mospërputhje. Dhe ajo që nuk më rri dhe

mbase edhe e kam thënë, pika 2 e nenit 4 e 115-ës. Ne kemi përfitimet dhe pagat e anëtarëve të Gjykatës së Lartë. E kam thënë, nuk më rri për shumë arsye, sepse ne jemi një organ kushtetues, kolegjal, i pavarur, shlyqyr edhe i përhershëm. Nuk ka mundësi që ne të referojmë privilegjet tona tek... Unë nuk e di si u bë ligji atëherë, prandaj dhe kam dashur gjithmonë që të aplikojmë nenin 93 të 115-ës, opinione ligjore për të kundërshtuar disa, që më tepër e shoh që këto ndryshime na çojnë në autoritetin tonë, atë çka na buron nga Kushtetuta, pastaj edhe mund të kërkojmë akte nënligjore që referojnë, -atë që thamë. Për të tjerat, nuk ka problem. Ne këtu jemi. I flasim.

Kjo pra është. Të kihet parasysh fakti neve bëjmë referimin që ligji na jep të drejta dhe privilegjet e anëtarëve të Gjykatës së Lartë. Nuk më duket normale që...

Naureda Llagami: Në fakt, ka një lloj logjike.

Maksim Qoku: Ky është një opinion ligjor që ne mund ta vejmë. Është ideja që të bëhemi iniciatorë në ndryshimin e kësaj gjëje, pastaj të merremi me bazën nënligjore.

Naureda Llagami: Kjo është çështje ligji dhe ne në këtë momente nuk e diskutojmë dot. Ndoshta do ishte me vend që ta adresonim në institucionet përkatëse. Kështu që, kalojmë në miratimin e projekt-aktit?

Alban Toro: Kisha një pyetje.

Kjo pika 1, i referohet ndonjë akti nënligjor, apo ndonjë analogjizmi, apo...?

Naureda Llagami: Po! Akt nënligjor, po t'i referohemi tek ligji që ju thashë për Transportin publik. Aty është e shprehur shprehimisht që titullari i institucionit e ka pa limit.

Brikena Ukperaj: Unë kam diçka zonja Kryetare.

Në rastet kur ne, për shkak të punës gjithmonë, jemi të detyruar të dalim jashtë Tiranës, -si do të zgjidhet?

Pika 3, përfshihet edhe kjo?

Naureda Llagami: Po!

Kalojmë për votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit si më poshtë: Konsumimi mujor i karburatit për automjetin në dispozicion të Kryetares Këshillit Lartë Gjyqësor, do të jetë pa limit; Limiti mujor i konsumit të karburantit për çdo automjet në dispozicion të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, do të jetë 150 litra, për çdo muaj; Për automjetet e tjera dhe motorin në dispozicion të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor (limiti), shpenzimi do të jetë sipas normativës së konsumit për çdo automjet dhe (motorin) km të kryera sipas fletë udhëtimeve të mbajtura, referuar distancave kilometrike ndërqytetëse, të miratuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës; Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit dhe Drejtoria e Shërbimeve Administrative, pranë institucionit.

Atëherë, nëse nuk keni ndonjë çështje tjetër për të diskutuar, unë e konsideroj këtë mbledhje të mbyllur.

Brikena Ukperaj: Kryetare, kam diçka në fakt.

Nisur nga situata emergjente e krijuar në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Shkodër. Aktualisht gjykata është vetëm me 1 gjyqtar të transferuar, që i mbaron transferimi në shkurt, -në shtator, më falni, dhe njëkohësisht nuk ka gjyqtarë tjetër, s'ka kryetar, s'ka zëvendëskryetar. Ata edhe pagën nuk e marrin dot, se s'ka kush e firmos. Ndoshta duhet të shikojmë një mënyrë emergjente për të vepruar?

Naureda Llagami: Sikurse ju kam vënë edhe në dijeni, unë kam përgatitur një listë të çështjeve urgjente që ne duhet të reagojmë shumë shpejt si Këshill dhe jua kam shpërndarë me e-mail, dhe pa diskutim që shqetësimi që ju ngritët është një nga çështjet që unë e kam renditur si çështje urgjente për t'u marrë nga Këshilli. Kështu që unë do

ftoja Komisionin përkatës të bëjë vlerësimin lidhur me situatën dhe të vijë me propozime konkrete. Jam e gatshme që të lejë mbledhje, qoftë edhe brenda uikendit (*weekend-it*) ose gjatë javës, kur ta keni të arsyeshme, të më propozoni dhe mblidhemi direkt.

Faleminderit! Punë të mbarë!

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor